

Termet e Referencës: Ekspert për Protokollin e Monitorimit për *Salmo letnica* në Liqenin e Pogradecit

1. Hyrje

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, përmes Grantit PONT në Peizazhin e Mbrojtur Ujor / Tokësor të Liqenit të Pogradecit (PA_025), duke ndjekur planin operacional të dakordësuar për këtë zonë të mbrojtur, është e angazhuar në monitorimin dhe ruajtjen e specieve treguese si një komponent kyç i menaxhimit të përgjithshëm të zonës së mbrojtur së bashku me habitatet kryesore. Për të siguruar efektivitetin e përpjekjeve tona për ruajtje, ne po kërkojmë një ekspert me përvojë për të kryer një studim në lidhje me "Protokollin e Monitorimit për *Salmo letnica* në Liqenin e Pogradecit".

2. Objektivat

Objektivat kryesore të angazhimit të ekspertit janë si më poshtë: a. Të prodhojë një raport mbi Protokollin e Monitorimit për *Salmo letnica* për të dy pjesët e Liqenit të Ohrit (Pogradeci).

3. Qëllimi

Eksperti do të jetë përgjegjës për një raport mbi Protokollin e Monitorimit për *Salmo letnica* për Liqenin e Pogradecit, që do të ndihmojë AdZM-në e Korçës në zbatimin e protokollit të monitorimit të specieve.

4. Kohëzgjatja

Konsulenca pritet të fillojë më 15 korrik dhe të përfundojë më 1 shtator. Detyra do të përqendrohet në Peizazhin e Mbrojtur Ujor / Tokësor të Liqenit të Pogradecit.

5. Reportimi

Eksperti do të dorëzojë një raport tek Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura së bashku me rekomandimet.

6. Kualifikimet

Kandidati duhet të ketë:

- a. 5 - 10 vite përvojë në fushën e ekspertizës së biodiversitetit
- b. Ekspertizë të dëshmuar në përbërjen e habitatit dhe specieve të Peizazhit të Mbrojtur Ujor / Tokësor të Liqenit të Pogradecit.
- c. Njohuri me kontekstin ekologjik të zonës së projektit.

7. Buxheti

Buxheti për konsulencën referohet linjave të buxhetit:

- Aktiviteti Nr. 2.3 "Protokoll Monitorimi për *Salmo letnica* për Liqenin e Pogradecit"

Duke bërë vlerën totale të kësaj konsulence 600 Euro duke përfshirë 15% të taksave.

8. Procesi i Aplikimit dhe Afati

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë një CV deri më 7 korrik në adresën info@akzm.gov.al